

WORCESTER PUBLIC SCHOOLS

John N. Staley
Assistant Principal

DOHERTY MEMORIAL HIGH SCHOOL

299 Highland Street
Worcester, MA 01602-2193
508-799-3282

StaleyJ@worcesterschools.net

I Dashur Prind/Kujdestar:

Gjatë përgatitjes tuaj dhe të fëmijës tuaj për të shkuar në shkollën e mesme (high school) në këtë vjeshtë 2020, unë ju inkurajoj ju që të konsideroni Akademinë e Inxhinierisë&Teknologjisë (ETA) në Doherty Memorial High School, si një program rigoroz, përgatitës për një kolegji 4 vjeçar, dhe si një program profesional.

Akademia e Inxhinierisë&Teknologjisë (ETA) u themelua në vitin 2002, dhe morri kartën (charter) profesionale në vitin 2009. Në klasat e 9 dhe 10, nxënësit e ETA bashkohen në grupe, të ngjashme me eksperiencat e nxënësve në shumë shkolla tetëvjeçare. Ky model ka ndihmuar në lehtësimin e sfidave që ndeshin nxënësit gjatë tranzicionit nga shkolla tetëvjeçare në atë të mesme. Për të ndihmuar më tej performancën e nxënësve, mësuesit ETA në Klasën e 9 përdorin strategjitë dhe filozofitë e AVID, të cilat e vënë theksin në aftësitë e mira të nxënësve, siç janë mbajtja e shënimeve efikase, menaxhimi i kohës, strategjitë e studimit, dhe organizimi. Në klasat 11 dhe 12 nxënësit mund të vazhdojnë që të marrin klasa të Inxhinierisë dhe Teknologjisë, edhe pse ata nuk janë të bashkuar në grupe gjatë gjithë subjekteve të tyre akademike. Kjo gjë ju ofron nxënësve akses më të madh në sferën zgjedhëse, Vendosijen e Avancuar (AP), dhe në klasat Virtuale të High School që ofrohen në Doherty.

Akademia e Inxhinierisë&Teknologjisë punon nga afër me bizneset lokale, industrinë dhe institutet e arsimit të lartë. Për shembull, partneriteti i ETA me Worcester Polytechnic Institute u njoh në shkallë kombëtare nga American Society for Engineering Education si një shkollë e mesme dhe ekip universitar kryesor (premier). Boston Museum of Science e ka paraqitur ETA si një shembull të bashkimit të fortë ndërmjet shkollave publike dhe instituteve post-sekondare. Ne ofrojmë klasa sfiduese honors dhe klasa të vendosjes së avancuar, lidhje të forta biznesi, dhe marrëveshje artikuli me institucione post-sekondare dhe të arsimit të lartë 2 dhe 4 vjeçar lokal.

Nxënësit tanë gjithashtu shkëlqejnë në organizatat studentore. Doherty ka 36 skuadra atletike dhe mbi 30 klube dhe aktivitete. Për shkak të këtij rrjeti të madh organizatash, nxënësit janë në gjendje që të krijojnë shoqëri brenda dhe jashtë komunitetit të shkollës.

Shpresojmë që ju të merrni parasysh Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë në shkollën e mesme Doherty Memorial për arsimin e mesëm të fëmijës suaj. Çdo student i interesuar për të hyrë në ndonjë nga programet ose shkollat profesionale të qytetit duhet të plotësojë një aplikim.

Aplikimi do të jetë i disponueshëm online duke filluar nga 31 janari. Aplikimi dhe politika e re e pranimeve në programin profesional WPS, do të jenë të disponueshme në faqen e internetit të ETA-s, si dhe në faqen e rrugëve të karrierës në faqen e internetit të WPS. Aplikimet do të pranohen deri në datën 1 Prill, në të cilën pikë do të zhvillohet një short me nivele. Studentët mund të aplikojnë ende pas afatit të 1 Prillit, por fillimisht do të vendosen në listën e pritjes. Nëse aktualisht jetoni në Worcester dhe jetoni më shumë se 2,0 milje nga shkolla, transporti do t'i sigurohet fëmijës tuaj.

31 janar - Aplikimi online është i disponueshëm 1 prill - Afati i preferuar i aplikimit; ndodh llotaria me nivele

Sinqerisht,

John N. Staley
Assistant Principal